



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 645/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

- I. Riakreditoohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “Biznesi” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
  - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, (maksimum 250 student për vit akademik), Prishtinë, Gjakovë dhe Vushtrri;
  - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, (maksimum 250 student për vit akademik), Prishtinë, Gjakovë dhe Vushtrri;
  - Juridik Penal, LLM, 60 ECTS, (maksimum 100 student për vit akademik).
- II. Aprovohet kërkesa e BPrAL Kolegji “Biznesi” për hapjen e degës në Prizren për këto programe të studimit:
  - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, (maksimum 120 student për vit akademik);
  - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, (maksimum 120 student për vit akademik).

Kohëzgjatja e akreditimit të këtyre programeve të studimit, është e njëjtë me kohëzgjatjen e akreditimit të programeve të ofruara në qendër.
- III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- IV. Obligohet BPrAL Kolegji “Biznesi” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik

2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

- V. Obligohet BPrAL Kolegji “Biznesi” që deri më datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

### A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Biznesi” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit, dhe hapjen e degës në Prizren, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Banka dhe Financa në Biznes	BA	180	Kemajl Ramadani, Afrim Halili, Shyqeri Kabashi
2	Menaxhimi i Emergjencav	BA	180	Izet Shehu, Kudus Lama, Dije Dehari
3	Juridik Penal	LLM	60	Afrim Osmani, Sefer Megjedoviq, Sejdefa Gjafqe

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji “Biznesi” më datë 26.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Peter Mertens, Prof. Dr. Ingerborg Mottl, dhe Prof. Dr. Volker Gehmlich. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 06 Korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “Biznesi”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Biznesi”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë